

VENDIM
Nr. 1086, datë 28.12.2015

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE, NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR KRIJIMIN E NJË FONDI NDIHME, NË KUADËR
TË INICIATIVËS SË KËSHILLIT TË BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË
EVROPËS (CEB), “PËR FINANCIMIN E QENDRAVE TRANSITE DHE TË PRITJES
PËR VENDET EVROPIANE QË PRESIN REFUGJATË DHE EMIGRANTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, për krijimin e një fondi ndihme, në kuadër të iniciativës së Këshillit të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB), “Për financimin e qendrave transite dhe të pritjes për vendet evropiane që presin refugjatë dhe emigrantë”, në shumën 100 000 (njëqind mijë) euro.

2. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në programin buxhetor 01120, “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, shpenzime korrente, t’i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 100 000 (njëqind mijë) eurosh, për t’u përdorur si ndihmë financiare për qendrat transite dhe të pritjes për vendet evropiane që presin refugjatë dhe emigrantë.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama